

Emri i Lëndës : Hyrje në Shkencat Politike							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
PLS 101	A	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	5.00
Lektori		Ferdinand Xhaferaj, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program i Integruar					
Përshkrimi		PLS 101 është projektuar për t'i prezantuar studentëve lëndën e shkencave politike. Lënda ka tre kredite dhe fokusohet në historinë, fushën e veprimit dhe metodat që përdoren në shkencën politike. PLS 101 përbëhet nga katër blloqe bazë: 1. Së pari, lënda eksploron se çfarë është shkenca politike dhe shpjegon metodat shkencore në studimin e politikës. 2. Së dyti, lënda fokusohet në konceptet e shkencës politike, duke adresuar më në detaje koncepte si forca, shteti, kombi dhe duke debatuar mbi këto koncepte. 3. Së treti, lënda analizon teorinë politike, mendimtarët kryesorë politikë dhe ideologjitë kryesore politike. 4. Së katërti, lënda do të krahasojë sistemet politike, partitë politike, sistemet zgjedhore dhe do të shpjegojë grupet e interesit.					
Objektivat		Politika shpesh komentohet si një e keqe e domosdoshme. Por çfarë është politika? Cili është ndikimi i politikës në shoqëri dhe cili është raporti midis politikës dhe qeverisjes? Cili është ndikimi i politikës në mir-funksionimin e institucioneve? Lënda do të shtjellojë pyetjet e mësipërme në një mënyrë kritike me qëllimin për të realizuar tre objektiva kryesore: PLS 101 do të përmisojë kuptimin dhe perceptimin e studentëve për rolin e politikës. PLS 101 do të shtjellojë konceptet si forca, shteti, qeverisja, sovramiteti, dhe legjitimiteti me një fokusim të vecantë tek demokracia. Lënda do t'i prezantojë studentëve ndryshimet kryesore midis një regjimi demokratik dhe jo-demokratik. PLS 101 do të shpjegojë si punojnë institucionet politike dhe se si sjellja politike dhe institucionet ndërveprojnë për të krijuar produktin politik. Për rrjedhojë, lënda është projektuar që të zgjerojë njohuritë e studentëve më çështjet bashkëkohore politike.					
Konceptet Kryesore		1. Polikika 2. Metodat Shkencore në Politikë 3. Forca 4. Teoritë Politike 5. Etika 6. Demokracia 7. liberalizmi, 8. konservatorizmi, 9. Socializmi 10. Fashizmi 11. Nazismi 12. Feminizmi, 13. Postmodernizmi 14. Ambjentalizmi 15. Partitë Politike 16. Grupet e Interesit					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Prezantimi i silabusit. Shpjegimi se per çfare eshte dhe ku perqendrohet lenda Hyrje ne Shkencat Politike						
2	Çfarë është shkenca politike? Shpjegimet qe marrin persiper te bejne Shkencat Politike dhe metodat qe ato perdorin. Çfare eshte politika dhe cilat jane kater perkufizimet kryesore per politiken. Andrew Heywood ff 1-9, S. Hix and M. Whiting ff 11-19						
3	Metodat shkencore në politike. Çfare do te thote te mendosh ne menyre shkencore per politiken. Cilat jane perqasjet ne studimin e politikës? Conceptet, modelet dhe teorite. Andrew Heywood ff 12-23, S. Hix and M. Whiting ff 19-28.						
4	Metodat shkencore në politikë: (Fusha e shkencave politike: zhvillime historike). Çfare jane eksperimentet, quasi-eksperimentet, studimet e rasteve dhe anketimet? Cilat jane kufizimet ne studimin e politikës? Ellen Grigsby ff 12-39.						

5	Konceptet kryesore në shkencat politike: Forca dhe perkufizimi i saj. Llojet e forces dhe debati që zhvillohet në studimin e rolit të forces në shkencat politike. Është forca gjithmone e dhunshme? Cila është diferenca midis manipulimit dhe bindjes në ushtrimin e forces? Ellen Grigsby, ff 41-56.
6	Konceptet kryesore në shkencat politike: Shteti dhe Kombi. Çfarë është shteti, kombi dhe nacionalizmi? Llojet e nacionalizmit. Debatet që zhvillohen në studimin e shtetit dhe kombit. E ardhmja e Shtetit-komb. Ellen Grigsby ff 57-74. Andrew Heywood ff 56-79, ff 108-127.
7	Teoria politike: shtjellimi i bazamentit etik të politikës. Analizimi i teorisë politike dhe shpjegimi i Alegorisë së Shpelles së Platonit. Shpjegimi i qëllimeve kryesore që shteti duhet të shërbejë. Duhet shteti të organizohet për të maksimalizuar forcën apo duhet të kufizohet forca e shtetit? Duhet shteti të kontribuojë që shoqëria të jetë me etike? Ellen Grigsby ff 76-97.
8	Provimi gjysmëfinal
9	Demokracia dhe legjitimiteti. Shpjegimi i demokracisë dhe modeleve të saj. Legjitimiteti dhe stabiliteti politik. Rënia e regjimeve demokratike. Shpjegimi i problemeve që mbart tranzicioni demokratik dhe konsolidimi i demokracisë. S. Hix and M. Whiting ff 29-47. Andrew Heywood ff 80-107. Juan Linz ff 3-86. Juan Linz dhe Alfred Stepan ff 3-66.
10	Ideologjitë politike: liberalizmi, konservatorizmi, socializmi Shpjegimi se çfarë janë ideologjitë politike. Liberalizmi klasik dhe modern. Konservatorizmi tradicional. Shpjegimi i ideve kryesore ku mbështeten këto ideologji. Ellen Grigsby ff 98-127. Andrew Heywood ff 28-45.
11	Fashizmi dhe Nazizmi. Shpjegimi se çfarë janë këto ideologji. Shpjegimi se si fashizmi erdhi në pushtet në Itali dhe si u implementua nga Musolini. Shpjegimi se si gjermanët u bënë nazistë dhe si kjo ideologji erdhi në pushtet në Gjermani. Neofashizmi dhe neonazizmi në ditët aktuale në Europë. Ellen Grigsby ff 128-142. Peter Fritzsche, Germans into Nazis 1998. Zeev Sternhell ff 3-35, 195-206, 227-233.
12	Feminizmi, postmodernizmi dhe ambjentalizmi. Shpjegimi i lëvizjeve feminist liberale dhe radikale. Shpjegimi i principeve bazë të ideologjive ambjentaliste. Shpjegimi i modernizmit dhe post modernizmit. Ellen Grigsby ff 144-163. Andrew Heywood ff 49-53.
13	Teoritë kryesore në politiken botërore. Realizmi, liberalizmi dhe kontruktivizmi. Shpjegimi i realizmit klasik dhe neorealizmit. Shpjegimi i liberalizmit dhe globalizmit. Shpjegimi i principeve bazë të teorisë konstruktiviste. John Baylis, Steve Smith & Patricia Owens ff 84-165.
14	Politikë e krahasuar 1: Sistemet e qeverisjes: demokracia dhe regjimet jo demokratike. Modellet e regjimeve demokratike. Demokracia maxhoritare dhe konsensuale. Ellen Grigsby ff 165-192. Arend Lijphart ff 1-47.
15	Politikë e krahasuar 2: Grupet e interesit, partitë politike, dhe zgjedhjet . shpjegimi se çfarë janë partitë politike, grupet e interesit dhe sistemet zgjedhore. Funksionet e partive politike. Sistemet zgjedhore dhe zgjedhjet në një regjim demokratik dhe jo demokratik. Ku konsiston koncepti i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme. Ellen Grigsby ff 195-231. Andrew Heywood ff 196-264.
16	Provimi Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Andrew Heywood, "Key Concepts in Politics" Andrew Heywood, "Politics, 3e" S. Hix and M. Whiting, "Introduction to political science" • Ellen Grigsby (2009) An Introduction to Political Science, Wadsworth Cengage Learning. Info at: http://www.nicat-mammadli.narod.ru/b1.html/b35.pdf • S. Hix and M. Whiting (2012) Introduction to political science. University of London
Referenca të tjera	• David Beetham (2013) The Legitimation of Power 2nd Edition. Palgrave Macmillan • Juan J. Linz (1978) The Breakdown of Democratic Regimes. The Johns Hopkins University Press. Baltimore and London • Juan J. Linz & Alfred Stepan (1996) Problems of Democratic Transition and Consolidation. The Johns Hopkins University Press. Baltimore and London • Peter Fritzsche, Germans into Nazis. Harvard University Press (1998).. • Zeev Sternhell, The Birth of Fascist Ideology. Princeton University Press (1995). • John Baylis, Steve Smith & Patricia Owens. The Globalization of World Politics. Oxford University Press (2011). • Arend Lijphart. Patterns of Democracy. Yale University Press (1999).
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentët do të njihen me konceptet baze dhe natyrën e politikës, shtetin dhe qeverinë, bazuar në teoritë moderne të shkencave politike.
2	Studentët do të njihen me modelet e politikës dhe sjelljen e aktorëve politikë.
3	Studentët do të marrin njohuritë bazë mbi parimet e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të drejtave të njeriut.
4	Studentët do të formojnë njohuritë bazë dhe do të përgatiten për studime të mëtejshme të thelluara në shkencat politike.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	30	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	0	0
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	20	20
Provimi final	1	30	30
Të tjera	2	15	30
Ngarkesa totale e orëve			128
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.12
ECTS			5.00